

IKAF F3 Kontabiliteti Financiar

Syllabus dhe Udhëzues Studimi

Kualifikimi Teknik Kontabiliteti
(Bazuar në Certifikimet ACCA)

Ky planprogram dhe udhëzuesi i studimit është i dizajnuar për të ndihmuar në mësimdhënie dhe mësimnxënie, dhe ka për qëllim të ofrojë informata të hollësishme në lidhje me kualifikimin, modulën dhe udhëzuesin e studimit.

Struktura e Kualifikimit

Shpjegon përmbajtjen e kualifikimit të nivelit Teknik Kontabiliteti në të cilën bënë pjesë edhe moduli Kontabiliteti Financiar. Ndërlidhja e këtij moduli me nivelet dhe modulet tjera të kualifikimit. Modulet e përfshira në nivelin e caktuar si dhe kriteret për antarësim; si dhe karakteristikat e ligjeratave të cilat mbahen gjatë periudhës së certifikimit. Modulet dhe Kualifikimi janë paraqitur edhe me anë të diagramit.

Moduli

Shpjegon shkurtimisht arsyetimin e rëndësisë së modulit, objektivat e përgjithshme dhe të detajuara të modulit dhe tregon në kuptimin më të gjerë aftësitë që do të zhvillohen gjatë studimit të modulit në fjalë. Ndërlidhja e modulit me modulet tjera të caktuara paraqitet me anë të një diagrami, që paraqesin lidhjet ndërmjet tyre; me qëllim që të jetë sa më e qartë për lexuesin. Poashtu përshkruhen dhe temat që i përkasin modulit; se si është planifikuar moduli me tema dhe nëntema. Gjithashtu, shpjegohen edhe forma e ekzaminimit dhe vlerësimit, në detaje se çfarë do të shqyrtojë provimi dhe pse. Në fund krejt është bashkangjitur shtojca e përmbajtjes së modulit.

Struktura e Syllabusit

Shpjegon përmbajtjen e syllabusit të modulit Kontabiliteti Financiar i cili është pjesë e nivelit Teknik Kontabiliteti. Ky modul përmban arsyetimin, qëllimin dhe aftësitë kryesore që pritet të fitohen gjatë kohës së studimit. Veç kësaj syllabusi përfshinë edhe temat e modulit në fjalë, strukturën e ekzaminimit pas përfundimit me sukses të modulit si dhe të lexuarit dhe planifikimin e kohës.

Udhëzuesi i Studimit

Ky është seksioni kryesor i të dhënave që nxënësit dhe mësimdhënësit duhet ta përdorin si bazë të studimeve, mësimve dhe materialeve të tyre përkatësisht. Provimet do të bazohen në detajet e udhëzuesit të studimit i cili identifikon në mënyrë gjithëpërfshirëse se çfarë mund të vlerësohet në çdo seancë provuese. Udhëzuesi i studimit është i ndarë në seksione të bazuara në aftësitë kryesore të identifikuara në programin mësimor. Këto seksione ndahen në fusha të lëndëve që lidhen me nën-aftësitë e përfshira në planprogramin e detajuar. Fushat e lëndëve ndahen në nëntituj që përshkruajnë rezultatet e detajuara që mund të vlerësohen në provime.


STRUKTURA E KUALIFIKIMIT

*Kualifikimi Teknik Kontabiliteti
(Bazuar në Certifikimet ACCA)*

Programi kualifikues për Teknik të Kontabilitetit, me theks të veçantë mbështetet në aftësitë menaxhuese dhe komunikuese, zhvillimin praktik të biznesit dhe aftësitë planifikuese si dhe po ashtu njohjet më të reja mbi mjedisin tatimor dhe raportimin financiar.

Për t'u trajnuar për Teknik të Kontabilitetit ju duhet të bëheni anëtar student i IKAF-it. Anëtarësimi është i hapur për profesionistë që punojnë në kontabilitet si dhe për ata që janë të interesuar në kontabilitet.


Kandidatët në Kualifikimin për Teknik Kontabiliteti duhet të demonstrojnë njohuri të veçanta edhe në modulin Kontabiliteti Financiar.



Diagrami.1.: Nderlidhjet e moduleve deri tek titulli Teknik Kontabiliteti

Modulet

Kualifikimi Teknik Kontabiliteti përmbanë gjithsej katër module të cilat duhet të studiohen dhe të përfundojnë me sukses; me qëllim të fitimit të titullit.



Diagrami.2.: Modulet e Kualifikimi Teknik Kontabiliteti

Kriteret e kualifikimit dhe anetaresimit: Teknik Kontabiliteti

- Për t'u regjistruar si student i IKAF-it në programin Teknik i Kontabilitetit, ju duhet që së paku të keni diplomën e Shkollës së Mesme ose Diplomë Universitare;
- Së paku një (1) vit përvojë pune në kontabilitet/financa – që mund të përfitohet gjatë apo edhe pas trajnimit.
- Të kenë vijuar dhe kaluar kater (4) provimet e certifikimit për këtë qëllim (Provimi quhet i dhene nese arrihet 50% e pikeve ne test).
- Personi që është i certifikuar në këtë kualifikim nga IKAF dhe vazhdon të jetë anëtar me status të rregullt pranë IKAF-it, ka të drejtë të përdor titullin “**Teknik të Kontabilitetit**” duke plotësuar gjitha kriteret e mesiperme.
- Antaret e rregullt ne IKAF për ta përdor titullin “**Teknik të Kontabilitetit**” e kane obligative ndjeken e edukimit te vazhdueshem professional (EVP/CPD) te percaktuara edhe ne rregullore te IKAF-it.

Karakteristikat e Ligjertes Trajnuese:

- Rishikimi i përgjithshëm i moduleve; dhe gjatë ligjertes, studentët do të jenë të pajisur me raste të studimit, shembujve të ngjashëm nga ato që trajtohen të testet ACCA, dhe shmebuj të provimeve.
- Ligjertesit mbajnë kualifikime profesionale si dhe eksperience pune në fushen e caktuar të ligjerimit.
- Planprogrami trjanues është i bazuar në planëprogramet ACCA.
- Në përfundim të kësaj ligjerate, studentet do të jenë te gatshëm ti nënshtrohen provimit në qendren e Institutit KAF.

STRUKTURA E SYLLABUSIT

Arsyetimi

Shpjegon se si është strukturuar programi dhe si janë të ndërlidhura aftësitë kryesore. Arsyetimi gjithashtu shpjegon në detaje se çfarë do të përmbajë ekzaminimi dhe pse.

Diagrami i relacioneve mes moduleve

Ky diagram tregon lidhjet e drejtpërdrejta dhe të tërthorta midis këtij moduli dhe moduleve të tjera që i paraprijnë ose pasojnë. Ai tregon se ku ju pritët të keni njohuri themelore dhe ku do të ishte e dobishme të rishikoni të mësuarit e mëparshëm përpara se të filloni studimin.

Qëllimi

Kjo shpjegon shkurtimisht objektivin e përgjithshëm të planprogramit dhe tregon në kuptimin më të gjerë aftësitë që duhet të zhvillohen brenda studimit të modulit.

Aftësitë kryesore

Qëllimi i planit mësimor është i ndarë në disa funksione kryesore që ndajnë programin mësimor dhe udhëzuesin studimor në seksione diskrete.

Temat

Temat e caktuara që i përmbanë moduli dhe që do të trajtohen gjatë studimit dhe ligjerimit.

Struktura e Ekzaminimit

Ky seksion shpjegon shkurtimisht strukturën e ekzaminimit dhe si bëhet vlerësimi.

Shtojcë Syllabusi i Detajuar

Kjo tregon ndarjen temave dhe nëntemave kryesore të planprogramit në fushat e lëndëve. Ky është pilotprojekt për manualin e detajuar të studimit.

MODULI

Arsyetimi

Syllabusi për librin FFA/F3, Fondacionet e kontabilitetit financiar e njoftojnë kandidatin me bazat e sistemit rregullator që ka të bëjë me përgatitjen e llogarive dhe karakteristikat cilësore të informacionit të dobishëm.



Diagrami.1.: Ndërlidhja e moduleve

Syllabusi e sqaron në thellësi procesin e regjistrimit, përpunimit dhe transaksionet dhe ngjarjet e biznesit. Silabusi e përfshin edhe përdorimin e bilancit vërtetues dhe identifikimin dhe korrigjimin e gabimeve dhe përgatitjen e pasqyrave themelore financiare për entitetet të ndërlidhura dhe të pa ndërlidhura. Syllabusi pastaj lëviz në dy drejtime, së pari kërkon kandidatët të jenë në gjendje të bëjnë interpretim të pasqyrave financiare; dhe së dyti të jenë në gjendje të përgatisin pasqyra financiare të thjeshta të konsoliduara duke u nisur nga pasqyrat financiare individuale të entiteteve të ndërlidhura.

Qëllimi


Që të zhvillohen njohuritë dhe të kuptohen parimet dhe konceptet që kanë të bëjnë me kontabilitetin financiar dhe aftësitë teknike në përdorimit e hyrjes së dyfishtë të kontabilitetit duke përfshirë përgatitjen e pasqyrave financiare themelore.

Aftësitë kryesore

- Sqarojnë hapësirën dhe qëllimin e raportimit financiar
- Definojnë karakteristikat cilësore të informatave financiare
- Demostrojnë Përdorimin e hyrjes së dyfishtë dhe sistemet e kontabilitetit
- Të bëjnë regjistrimin e transaksioneve dhe ngjarjeve
- Përgatisin bilancin vërtetues (duke e përfshirë identifikimin dhe korrigjimin e gabimeve)
- Përgatisin pasqyrat financiare themelore
- Përgatisin pasqyrat e thjeshta të konsoliduara
- Interpretojnë pasqyrat financiare

Temat

Temat kryesore të Modulit Kontabiliteti Financiar që do të trajtohen gjatë ligjërates:



Diagrami.2.: Temat që do të trajtohen në Modulën Kontabiliteti Financiar

Struktura e Ekzaminimit

Provimi mbahet në formë të shkruar dhe përmban pyetje nga të gjitha pjesët e tekstit. Testi do të ketë pyetje të hapura të cilat gjenden në kuadër të këtij teksti. Përgjigjet mund të nxirren nga leximi i tekstit dhe nga ligjëratat e mbajtura. Disa prej pyetjeve mund të kërkojnë përgjigje teorike, kurse pjesa më e madhe e tyre do të jenë pyetje të kombinuara dhe përgjigja jepet në kuadër të alternativave të dhëna në test.

Të lexuarit dhe planifikimi i kohës

Për 2 orët e provimit, janë konsideruar 15 minuta kohë për lexim dhe planifikim.

Kjo kohë shtesë është e lejuar në fillim të çdo provimi dy orësh për të lejuar kandidatët t'i lexojnë pyetjet dhe përgjigjet për të filluar planifikimin e tyre para se të fillojnë të shkruajnë përgjigjet. Kjo kohë duhet të përdoret për të siguruar që të gjitha informatat e kërkuara dhe provimi janë lexuar dhe kuptuar si duhet.

Shtojcë: Syllabusi i Detajuar

SYLLABUSI I DETAJUAR

A Hapësira dhe qëllimi i raportimit financiar

1. Hapësira dhe qëllimi i pasqyrave financiare për raportim të jashtëm
2. Nevojat e përdoruesit dhe grupet e interesit
3. Elementet kryesore të raporteve financiare
4. Kuadri rregullator
5. Detyrat dhe përgjegjësitë tek ato që janë të udhëhequr

B Karakteristikat cilësore të informatave financiare

1. Karakteristikat cilësore të informatave financiare

C Përdorimi i hyrjes së dyfishtë dhe sistemi i kontabilitetit

1. Parimet e hyrjes së dyfishtë të kontabilitetit duke përfshirë mbajtjen e
2. regjistrimeve
3. Llogaritë kryesore, librat e hyrjes së parë dhe ditari

D Regjistrimi i transaksioneve dhe ngjarjeve

1. Shitjet dhe blerjet
2. Paratë
3. Stoku
4. Pasuritë e prekshme joqarkulluese
5. Zhvlerësimi
6. Pasuritë e paprekshme joqarkulluese dhe amortizimi

7. Akrualet dhe parapagimet
8. Llogaritë e arkëtueshme dhe llogaritë e pagueshme
9. Provizionet dhe kontingjencat
10. Struktura e kapitalit dhe kostot financiare

E Përgatitja e bilancit vërtetues

1. Bilanci vërtetues
2. Korrigjimi i gabimeve
3. Llogaritë kontrolluese dhe rakordimet
4. Rakordimet bankare
5. Llogaritë e përkohshme

F Përgatitja e pasqyrave financiare themelore

1. Bilanci i gjendjes
2. Pasqyra e të ardhurave dhe pasqyra e të ardhurave përmbledhëse
3. Shënimet e dhënies së informatave shpjeguese
4. Ngjarjet pas periudhës së raportimit
5. Pasqyra e rrjedhës së parasë (duke e përjashtuar ortakërinë)6. Regjistrimet e pakompletuara

G Përgatitja e pasqyrave financiare të konsoliduara të thjeshta

1. Filialet
2. Pjesëmarrjet

H Interpretimi i pasqyrave financiare

1. Rëndësia dhe qëllimi i analizës së pasqyrave financiare
2. Raportet
3. Analiza e pasqyrave financiare

Udhëzues Studimi

A HAPËSIRA DHE QËLLIMI I RAPORTIMIT FINANCIAR

1. Hapësira dhe qëllimi i raportimit financiar

- a) Definimi i raportimit financiar - regjistrimit, analizës dhe përmbledhjes së të dhënave financiare.
- b) Identifikimi dhe definimi i llojeve të njësive të biznesit - biznesit individual, ortakërisë dhe kompanisë me përgjegjësi të kufizuara.
- c) Njohja e dallimeve ligjore midis biznesit individual, ortakërisë dhe kompanisë me përgjegjësi të kufizuara.
- d) Identifikimi i avantazheve dhe disavantazheve të operimit si kompani me përgjegjësi të kufizuara, biznes individual dhe ortakëri.
- e) Të kuptuarit e natyrës, parimeve dhe hapësirës së raportimit financiar.

2. Nevojat e përdoruesit dhe grupet e interesit

- a) Identifikimi i përdoruesve të pasqyrave financiare dhe dallimi i tyre sipas informatave që i nevojiten.

3. Elementet kryesore të raporteve financiare

- a) Kuptimi dhe identifikimi i qëllimit të secilës pasqyrë financiare.
- b) Definimi dhe identifikimi i pasurive, detyrimeve, ekuitetit, të hyrave dhe shpenzimeve.

4. Kuadri rregullator

a) Të kuptuarit e rolit të sistemit rregullator duke përfshirë rolet e Fondacionit IFRS (IFRSF), Bordi i Standardeve Ndërkombëtare të Kontabilitetit (IASB), Këshilli Konsultativ i IFRS (IFRS AC) dhe Komiteti i Interpretimeve i IFRS (IFRS IC).

b) Të kuptuarit e rolit të Standardeve Ndërkombëtare të raportimit financiar.

5. Detyrat dhe përgjegjësitë tek ata që janë të udhëhequr

- a) Përshkrimi i fjalës të jesh i udhëhequr në hapësirën e përgatitjes së pasqyrave financiare
- b) Përshkrimi i detyrave dhe përgjegjësive të drejtorit dhe palëve tjera në përgatitjen e pasqyrave financiare.

B KARAKTERISTIKAT CILËSORE TË INFORMATAVE FINANCIARE

1. Karakteristikat cilësore të informative financiare

a) Definimi, kuptimi dhe përdorimi i koncepteve të kontabilitetit dhe karakteristikave cilësore.

(i) Paraqitja e drejtë

(ii) Vijimësia

(iii) Parimi aktual i kontabilitetit

(iv) Qëndrueshmëria

(v) Materialiteti

(vi) Përkatësia

(vii) Besueshmëria

- (viii)Përfaqësimi besnik
- (ix)Substanca mbi formën
- (x)Neutraliteti
- (xi)Kujdesi
- (xii)Plotësia
- (xiii)Krahasueshmëri
- (xiv)Kuptueshmëria
- (xv)Konceptet e njësisë së biznesit.

b)Të kuptuarit e ekuilibrit midis karakteristikave cilësore.

C PËRDORIMI I HYRJES SË DYFISHTË DHE SISTEMI I KONTABILITETT

1. Parimet e hyrjes së dyfishtë të kontabilitetit duke përfshirë mbajtjen e regjistrimeve

- a)Identifikimi dhe sqarimi i funksionit të të dhënave kryesore në kontabilitet.
- b) Përshkrimi dhe sqarimi i llojeve të ndryshme të dokumenteve të biznesit duke përfshirë: ofertën, porosinë për blerje, porosinë për shitje, shënimin për mallrat e shitura, shënimin për mallrat e blera, faturën, deklaratën, shënimin kredi, shënimin debi, vërtetimin.
- c) Kuptimi dhe përdorimi i konceptit të hyrjes së dyfishtë në kontabilitet.
- d)Kuptimi dhe përdorimi i ekuacionit kontabël.
- e)Kuptimi se si sistemi kontabël kontribuon në gjetjen e informatave të

dobishme që përputhen me politikat dhe afatet e njësisë ekonomike

f)Identifikimi i llojeve kryesore të transaksioneve të biznesit p.sh. shitjet, blerjet, pagesat, arkëtimet.

2. Llogaritë analitike, librat e hyrjes së parë dhe ditari

a) Identifikimi i llojeve të llogarive kryesore dhe librave të hyrjes së parë dhe kuptimi i natyrës dhe funksionit të tyre.

b)Përshkrimi i detyrave dhe përgjegjësi të

b)Kuptimi i përdorimit të ditarit dhe postimet e drejtorit dhe palëve tjera në përgatitjen e pasqyrave financiare. hyrjeve në llogaritë analitike.

c)Identifikimi i ditarit të saktë nga të dhënat narrative. [S]

d) Barazimi dhe mbyllja e llogarive analitike.

D REGJISTRIMI I TRANSAKSIONEVE DHE NGJARJEVE

1. Shitjet dhe blerjet

a)Regjistrimi i transaksioneve të shitjes dhe blerjes në llogarinë analitike.

b)Të kuptuarit dhe regjistrimi i kthimit të shitjes dhe blerjes.

c)Regjistrimi i kthimit të blerjes dhe shitjes.

d)Parimet themelore të funksionimit të tatimit e shitjes.

e) Llogaria e skontimit të dhënë dhe llogaria e skontimit të pranuar.

2. Paratë

- a) Regjistrimi i transaksioneve me para në llogaritë analitike.
- b) Të kuptuarit e nevojës për regjistrimin e transaksioneve me para të gatshme.

3. Stoku

- a) Të kuptuarit e nevojës për rregullimin e stokut në përgatitjen e pasqyrave financiare.
- b) Regjistrimi i stokut fillestar dhe stokut përmbyllës.
- c) Identifikimi i metodave alternative për vlerësimin e stokut.
- e) Përfshirja e kostove në vlerësimin e stokut.
- f) Të kuptuarit e përdorimit të periudhës së vazhdueshme dhe periudhës së fundit në regjistrimet e stokut.
- g) Kalkulimi i vlerës së stokut përmbyllës duke përdorur FIFO (hyrje e pare, dalje e parë) dhe AVCO (kostoja mesatare).
- h) Ndikimi i koncepteve të kontabilitetit ndaj vlerësimit të stokut.
- i) Identifikimi i ndikimit të metodave të vlerësimit të stokut ndaj fitimit dhe pasurisë.

4. Pasuritë e prekshme joqarkulluese

- a) Definimi i pasurisë joqarkulluese.

b) Njohja e dallimeve në mes pasurive qarkulluese dhe joqarkulluese.

c) Sqarimi i dallimit në mes kapitalit dhe zërave të të hyrave.

d) Klasifikimi i shpenzimeve si shpenzime kapitale ose shpenzime të të hyrave.

e) Përgatitja e hyrjeve në llogaritë analitike për regjistrimin e blerjeve dhe nxjerrjeve të pasurive joqarkulluese jashtë përdorimit.

f) Kalkulimi dhe regjistrimi i fitimit ose humbjes nga nxjerrja e pasurisë joqarkulluese jashtë përdorimit në pasqyrën e të ardhurave duke I përfshirë edhe transaksionet e këmbimit të pjesshëm

g) Regjistrimi i rivlerësimit të pasurisë joqarkulluese në llogaritë analitike, pasqyrën e të ardhurave përmbledhëse dhe bilancin e gjendjes

h) Kalkulimi i fitimit ose humbjes nga nxjerrja e pasurisë së rivlerësuar jashtë përdorimit.

i) Shpallja e bilancit dhe lëvizjes së pasurive joqarkulluese në pasqyrat financiare

j) Qëllimi dhe funksioni i regjistrit të pasurisë.

5. Zhvlerësimi

- a) Të kuptuarit e qëllimit të zhvlerësimit, amortizimi

b) Kalkulimi i zhvlerësimit me përdorimin e metodës lineare dhe metodës së reduktimit të bilancit.

c) Identifikimi i rrethanave ku metodat e ndryshme të zhvlerësimit do të jenë të përshtatshme.

d) Regjistrimi i zhvlerësimit dhe zhvlerësimit të akumuluar në llogaritë analitike.

e) Kalkulimi i zhvlerësimit të pasurisë joqarkulluese të rivlerësuar duke e përfshirë transferin e zhvlerësimit të tepërt në mes rezervës së rivlerësuar dhe fitimeve të mbajtura.

f) Kalkulimi i rregullimeve të nevojshme për zhvlerësimin nëse bëhen ndryshime në jetën e dobishme/ose vlerën e mbetur të pasurisë joqarkulluese.

g) Regjistrimi i zhvlerësimit në pasqyrën e të ardhurave dhe në bilancin e gjendjes.

6. Pasuritë joqarkulluese të paprekshme dhe amortizimi

a) Njohja e dallimeve në mes pasurive të e prekshme joqarkulluese dhe pasurive të paprekshme joqarkulluese.

b) Identifikimi i llojeve të pasurive të paprekshme

c) Identifikimi i definicionit dhe trajtimit të “kostos së hulumtimit” dhe “kostos së zhvillimit” në përputhje me Standardet ndërkombëtare të raportimit financiar

d) Kalkulimi i shumave që duhet të kapitalizohen si shpenzime për zhvillim

ose do të shpenzohen nga informatat e dhëna.

e) Sqarimi i qëllimit të amortizimit.

f) Kalkulimi dhe regjistrimi i amortizimit.

7. Akrualet dhe parapagimet

a) Të kuptuarit e konceptit të përputhjes dhe aplikimi i tij ndaj akrualeve dhe parapagimeve.

b) Identifikimi dhe kalkulimi i rregullimeve të nevojshme për akrualet dhe parapagimet në përgatitjen e pasqyrave financiare.

c) Sqarimi i procesit të rregullimeve të akrualeve dhe parapagimeve në përgatitjen e pasqyrave financiare.

d) Regjistrimet në ditar dhe në llogaritë analitike për akrualet dhe parapagimet.

e) Kuptimi dhe identifikimi i ndikimit të akrualeve dhe parapagimeve mbi fitimin dhe pasuritë neto.

8. Llogaritë e arkëtueshme dhe llogaritë e pagueshme

a) Identifikimi i shembujve të llogarive të arkëtueshme dhe llogarive të pagueshme.

b) Identifikimi i përfitimeve dhe kostove nga ofrimi i kredive ndaj klientëve.

c) Kuptimi i qëllimit të analizës së arkëtimit të vjetra.

d) Të kuptuarit e qëllimit të limitit kreditor.

e)Përgatitja e regjistrimeve për shlyerjen e borxheve të këqija (të parikuperueshme).

f)Regjistrimi i pranimit të borxheve të këqija (të parikuperueshme).

g)Identifikimi i ndikimit të borxheve të parikuperueshme ndaj pasqyrës së të ardhurave dhe bilancit të gjendjes.

h)Përgatitja e regjistrimeve për krijimin dhe rregullimin e lejimit të arkëtimeve.

i)Përfshirja e lëvizjeve të lejimit për arkëtimet në pasqyrën e të ardhurave dhe paraqitja e bilancit përmbyllës së lejimit në bilancin e gjendjes.

j)Shlyerja në mes llogarive të arkëtueshme tregtare dhe llogarive të pagueshme tregtare.

k)Përgatitja, rakordimi dhe kuptimi i qëllimit të deklaratave të furnitorëve.

l)Klasifikimi i zërave si detyrime afatgjata në bilancin e gjendjes.

9. Provizionet dhe kontingjencat

a)Të kuptuarit e definicionit të “provizionit”, “detyrimit kontingjent” dhe “pasurisë kontingjente”.

b)Dallimi dhe klasifikimi i zërave si provizione, detyrime kontingjente ose pasuri kontingjente.

c)Identifikimi i metodave të ndryshme për provizionet, detyrimet kontingjente dhe pasuritë kontingjente.

d)Kalkulimi i provizioneve

e)Llogaritja e lëvizjeve të provizioneve.

f)Raportimi i provizioneve në llogaritë përfundimtare.

10. Struktura e kapitalit dhe shpenzimet e financimit

a)Të kuptuarit e strukturës së kapitalit të kompanisë me përgjegjësi të kufizuara duke i përfshirë:

(i)Aksionet e zakonshme

(ii)Aksionet preferenciale (të tërheqshme dhe të patërheqshme)

(iii)Shënimet për huazim

b)Regjistrimi i lëvizjeve të kapitalit aksionar dhe llogarisë së primit të lidhur me aksionet.

c)Identifikimi dhe regjistrimi i rezervave tjera të cilat mund të shfaqen në bilancin e gjendjes së kompanisë.

d)Definimi i emetimit falas (kapitalizimin) dhe avantazhet dhe disavantazhet e tij.

e)Definimi i emetimit e të drejtave dhe avantazhet dhe disavantazhet e tij.

f)Regjistrimi i emetimit falas (kapitalizimin) dhe efektet e tija ndaj bilancit të gjendjes.

g)Regjistrimi i emetimit e të drejtave (kapitalizimin)

E Përgatitja e Bilancit Vertetues

1. Bilanci vërtetues

a) Identifikimi i qëllimit të bilancit vërtetues.

b) Regjistrimi i llogarive analitike në bilancin vërtetues

c) Përgatitja e fragmenteve të hapjes së bilancit vërtetues

d) Identifikimi dhe kuptimi i kufizimeve të bilancit vërtetues.

2. Korigjimi i gabimeve

a) Identifikimi i llojeve të gabimeve që mund të ndodhin në sistemet kontabël.

b) Identifikimi i gabimeve që mund të theksohen nga bilanci vërtetues.

c) Përgatitja e regjistrimeve në ditar për korigjimin e gabimeve

d) Ndikimi i gabimeve mbi pasqyrën e të ardhurave, pasqyrën e të ardhurave përmbledhëse dhe bilancin e gjendjes

3. Llogaritë kontrolluese dhe rakordimi

a) Të kuptuarit e qëllimit të llogarive kontrolluese për llogaritë e arkëtueshme dhe llogaritë e pagueshme.

b) Të kuptuarit e marrëdhënies në mes llogarive kontrolluese dhe sistemit të hyrjes së dyfishtë.

c) Përgatitja e llogarive analitike kontrolluese nga informatat e dhëna.

d) Përgatitja e rakordimeve të llogarisë kontrolluese për llogaritë e arkëtueshme dhe llogaritë e pagueshme.

e) Identifikimi i gabimeve të cilat theksohen nga rakordimi i llogarisë kontrolluese.[

f) Identifikimi dhe korigjimi i gabimeve në llogaritë kontrolluese dhe në llogaritë analitike.

4. Rakordimi bankar

a) Të kuptuarit e qëllimit të rakordimit bankar.

b) Identifikimi i arsyeve kryesore për dallimet në mes librit të arkës dhe deklaratës bankare.

c) Korigjimi i gabimeve dhe/ose lëshimeve në librin e arkës

d) Përgatitja e deklaratës së rakordimit bankar.

e) Nxjerrja e bilanceve të deklaratës bankare dhe bilanceve të librit të arkës nga informatat e dhëna.

f) Identifikimi i bilancit bankar që do të raportohet në llogaritë përfundimtare.

5. Llogaritë e përkohshme

a) Të kuptuarit e qëllimit të llogarisë së përkohshme.

b) Identifikimi i gabimeve që sjellin krijimin e dhe efektet e tija ndaj bilancit të gjendjes.

h) Regjistrimi i dividendëve në llogaritë analitike dhe llogarisë së përkohshme. në pasqyrat financiare.

i) Kalkulimi dhe regjistrimi i kostove financiare në llogaritë analitike dhe në pasqyrat financiare.

j) Identifikimi i komponentëve të pasqyrës së ndryshimeve në ekuitet.

F PËRGATITJA E PASQYRAVE FINANCIARE THEMELORE

1. Bilanci i gjendjes

a) Identifikimi si ekuacioni kontabël, trajtimet kontabël të përcaktuara në Pjesën D, E dhe dokumentet ekzaminuese dhe konventa e njësisë së biznesit përbëjnë bazën e bilancit të gjendjes.

b) Të kuptuarit e natyrës së rezervave

c) Identifikimi dhe raportimi i rezervave në bilancin e gjendjes.

d) Përgatitja e bilancit të gjendjes ose fragmenteve të tij nga informatat e dhëna duke përdorur trajtimet kontabël të përcaktuara në pjesët D, E dhe dokumentet ekzaminuese.

e) Paraqitja e fitimeve të mbajtura në bilancin e gjendjes së kompanisë.

2. Pasqyra e të ardhurave dhe pasqyra e të ardhurave përmbledhëse

a) Përgatitja e pasqyrës së të ardhurave dhe pasqyrës së të ardhurave përmbledhëse ose ekstrakteve të tyre nga informatat e dhëna duke i përdorur trajtimet kontabël të përcaktuara në pjesët D, E dhe dokumentet ekzaminuese.

b) Aplikimi i koncepteve kontabël mbi të hyrat dhe shpenzimet.

c) Kalkulimi i të hyrave, kostos së shitjeve, fitimit bruto, fitimit për vitin dhe gjithsej të ardhurat përmbledhëse nga informatat e dhëna.

d) Shpалosja e zërave të të ardhurave dhe shpenzimeve në pasqyrën e të ardhurave.

e) Regjistrimi i tatimit mbi të ardhurat në pasqyrën e të ardhurave të kompanisë duke përfshirë provizionin me të madh ose me të vogël të tatimit në vitin paraprak.

f) Të kuptuarit e lidhjes në mes bilancit të gjendjes, pasqyrës së të ardhurave dhe pasqyrës e të ardhurave përmbledhëse.

g) Identifikimi i zërave që kërkojnë shpалosje të veçantë në pasqyrën e të ardhurave

3. Shënimet e dhënies së informatave shpjeguese

a) Qëllimi i shënimeve të dhënies së informative shpjeguese

b) Hartimi i shënimeve të dhënies së informative shpjeguese

(i) Pasuritë joqarkulluese duke i përfshirë pasuritë e prekshme dhe paprekshme

(ii) Provizionet

(iii) Ngjarjet pas periudhës së raportimit

(iv) Stoku

4. Ngjarjet pas periudhës së raportimit

a) Definimi i ngjarjeve pas periudhës së raportimit në përputhje me Standardet ndërkombëtare të raportimit financiar

b) Klasifikimi i ngjarjeve si ngjarje që rregullohen dhe ngjarje që nuk rregullohen.[

c) Raportimi i ngjarjeve që rregullohen dhe atyre që nuk rregullohen në pasqyrat financiare

5. Pasqyra e rrjedhës së parasë (duke e përjashtuar ortakërinë)

a) Dallimi në mes fitimit dhe rrjedhës së parasë.

b) Të kuptuarit e nevojës së menaxherëve për kontrollimin e rrjedhës së parasë.

c) Njohja e avantazheve dhe disavantazheve të pasqyrës së rrjedhës së parasë për përdoruesit e pasqyrave financiare.

d) Klasifikimi i efekteve të transaksioneve ndaj rrjedhës së parasë.

e) Kalkulimi i figurave që nevojiten për pasqyrën e rrjedhës së parasë duke përfshirë:

(i) Rrjedhën e parasë nga aktivitetet operative

(ii) Rrjedhën e parasë nga aktivitetet investuese

(iii) Rrjedhën e parasë nga aktivitetet financuese

f) Kalkulimi i rrjedhës së parasë nga aktivitetet operative duke përdorur metodën direkte dhe metodën indirekte.

g) Përgatitja e pasqyrës së rrjedhës së parasë dhe fragmenteve të saj nga informatat e dhëna.

h) Identifikimi i trajtimit të transaksioneve të dhëna në pasqyrën e rrjedhës së parasë së kompanisë.

6. Regjistrimet e pakompletuara

a) Kuptimi i dhe aplikimi i teknikave të përdorura në situatat e regjistrimeve të pakompletuara

(i) Përdorimi i ekuacionit kontabël

(ii) Përdorimi i llogarive analitike për kalkulimin e figurave që mungojnë

(iii) Përdorimi i përmbledhjes së arkës dhe/ose bankës

(iv) Përdorimi i përqindjes së fitimit për kalkulimin e figurave që mungojnë.

G PËRGATITJA E PASQYRAVE FINANCIARE TË KONSOLIDUAR TË THJESHTA

1. Filialet

a) Definimi dhe përshkrimi i termeve të mëposhtme në kontekstin e kontabilitetit të grupit.

(i) Kompania mëmë

(ii) Filialet

(iii) Kontrolli

(iv) Pasqyrat financiare të konsoliduara ose të grupit

(v) Interesi jo-kontrollues

(vi) Investimi tregtar/i thjeshtë

b) Identifikimi i filialeve brenda strukturës së grupit.

c) Përshkrimi i komponentëve dhe përgatitja e bilancit të gjendjes së konsoliduar ose fragmenteve të tij duke përfshirë:

(i) Rregullimet e vlerës së drejtë në blerjen e tokës dhe objektet ndërtimore (duke I përjashtuar rregullimet e zhvlerësimit)

(ii) Vlerën e drejtë të shumës së transferuar nga arka dhe aksionet (duke i përjashtuar shumat e shtyra dhe kontingjente)

(iii) Eliminimin e bilanceve tregtare brenda grupit (duke e përjashtuar arkën dhe mallrat në transit)

(iv) Heqjen e fitimit të përealizuar nga tregtia brenda grupit

(v) Blerjen e filialeve në mënyrë të pjesshme gjatë vitit financiar

d) Kalkulimi i goodwill-it (duke e përjashtuar çvlerësimin e goodwill-it) duke e përdorur metodën e plotë e goodwill-it si në vijim: Vlera e drejtë e shumës X Vlera e drejtë e interesit jo-kontrollues X Minus vlera e drejtë e pasurisë neto në blerje (X) Goodwill-i në blerje X

e) Përshkrimi i komponentëve dhe përgatitja e pasqyrës së konsoliduar të të ardhurave përmbledhëse ose fragmenteve të saj duke përfshirë:

(i) Eliminimin e bilanceve tregtare brenda kompanisë (duke e përjashtuar arkën dhe mallrat në transit)

(ii) Heqjen e fitimit të përealizuar nga tregtia brenda grupit

(iii) Blerjen e filialeve në mënyrë të pjesshme gjatë vitit financiar

2. Pjesëmarrjet

a) Definimi dhe identifikimi i pjesëmarrjeve dhe ndikimit të rëndësishëm dhe identifikimi i situatave ku ekziston ndikimi i rëndësishëm ose interesi pjesëmarrës.

b) Përshkrimi i karakteristikave kryesore të marrëdhënies kompani mëmë-pjesëmarrje dhe identifikimi i pjesëmarrjes brenda strukturës së grupit.

c) Përshkrimi i parimit të përlllogaritjes së ekuitetit.

H INTERPRETIMI I PASQYRAVE FINANCIARE

1. Rëndësia dhe qëllimi i analizës së pasqyrave financiare

a) Përshkrimi se si interpretimi dhe analiza e pasqyrave financiare përdoren në mjedisin e biznesit.

b) Sqarimi i qëllimit të interpretimit të raporteve.

2. Raportet

a) Kalkulimi i raporteve themelore të kontabilitetit.

(i) Rentabiliteti

(ii) Likuiditeti

(iii) Efikasiteti

(iv) Pozita

b) Sqarimi i marrëdhënieve midis raporteve.

3. Analiza e pasqyrave financiare

a) Kalkulimi dhe interpretimi I marrëdhënieve midis elementeve të pasqyrave financiare të lidhura me rentabilitetin, likuiditetin, përdorimin efikas I burimeve dhe pozicionin financiar.

b) Shkrimi i konkluzioneve të vlefshme nga informatat e përfshira brenda pasqyrave financiare dhe paraqitja e tyre ndaj përdoruesve të duhur të pasqyrave financiar